



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË



STANDARDET E AKREDITIMIT TË SHËRBIMIT STOMATOLOGJIK (Draft)



Tiranë, Tetor 2008

Ky dokument është publikim i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Qendrës së Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore QK-CSA në Shqipëri, dhe ka për qëllim të ndihmojë shërbimin stomatologjik publik dhe private në përmirësimin e cilësisë dhe performancës së tyre bazuar në standardet më të përparuara që rekomandohen nga institucionet ndërkombëtare.

Autorët : Vladimir GUSMARI*, Dorjan HYSI**, Rozarka BUDINA**, Nazmi KOÇI**, Esat BARDHOSHI**, Foto TOTI**, Marjana NUSHI**, Çiljeta PASHOLLI**, Gentian DURO**, Luli HANKU**, Fejzi KERAJ**, Xhensila FRASHËRI**, Klevis THOMAI**, Sidrit BEQIRAJ**, Ina THERESKA**, Prof. Dr Isuf KALO*** (Kryetar Grupi)

Redaktoi: Dr.Ines ÇULLAJ

Grupi i punës mbi standardet e cilësisë:

*** Isuf KALO, Drejtor i Qendrës së Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucionve Shëndetësore QK-CSA (Kryetar Grupi)

* Vladimir GUSMARI, Përgjegjës i Departamentit të Standardeve dhe Akreditimit në Qendrën e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore QK-CSA (Nen kryetar dhe Kordinator per QK-CSA)

**Dorjan HYSI, Departamenti i Stomatologjisë, Fakulteti i Mjekësisë (Kordinator për Profesionistet e Stomatologjisë).

** Rozarka BUDINA, Drejtor në Klinikën Stomatologjike Universitare

** Nazmi KOÇI, Specialist Stomatolog, ASHR Tiranë

** Esat BARDHOSHI, Kirurg Maksillofacial, Fakulteti i Mjekësisë

** Foto TOTI, Protezist, Stomatolog

** Marjana NUSHI, Shërbimi Stomatologjik Publik i Tiranës

** Çiljeta PASHOLLIM, Ministria e Shëndetësisë, Sektori i Stomatologjisë

** Gentian DURO, Shërbimit Stomatologjik Publik i Tiranës

** Luli HANKU, Shërbimi Stomatologjik Publik i Tiranës

** Fejzi KERAJ, Departamenti i Stomatologjisë, Fakulteti i Mjekësisë

** Xhensila FRASHËR, QK-CSA

** Klevis THOMAI, QK-CSA

** Sidrit BEQIRAJ, Shoqata e Stomatologëve Shqiptar

** Ina THERESKA, Qendra e Kontrollit të Barnave

PËRMBAJTJA E LËNDËS

PARATHËNIE	5
HYRJE	6
TERMINOLOGJIA.....	7
LISTA E STANDARDEVE TË PRAKTIKAVE APO SHËRBIMEVE STOMATOLOGJIKE	10
1. Mjedisi, Pajisjet dhe Aparaturat.....	10
2. Mbrojtja nga rreziqet në praktikën dentare.....	12
3. Kontrolli i Infeksionit	16
4. Shëndeti dhe siguria	24
5. Ekzaminimi Radiologjik Dentar	26
6. Laboratori Dentar	29
7. Kartela e pacientit	30
8. Stafi dhe trajnimi i tij.....	33
9. Emergjencat (urgjencat) Mjekësore	36
10. Informacioni për Pacientin.....	38
11. Komunikimi dhe regjistrimi i të dhënave.....	42
12. Kërkesat mediko-ligjore.....	44
13. Menaxhimi i praktikës dentare	46
14. Informatizimi i të dhënave	47
15. Parandalimi	48
16. Anestezia e përgjithshme dhe sedacioni me ruajtje të ndërgjegjes	51
ANNEX I.....	54
Pajisjet dentare dhe instrumentet.....	54
1. Pajisjet.....	54
2. Instrumentet	54
ANNEX II.....	56
Shëndeti dhe Siguria në punë.....	56
Vendi i punës	56
Menaxhimi.....	56
Pajisjet e punës.....	56
Ndihma e parë.....	57
Kontrolli i substancave të rrezikshme për shëndetin.....	57
Raportimi i dëmtimeve, sëmundjeve dhe rregullorja në rast aksidentesh.....	57
Pajisjet elektrike të lëvizshme	57
Periudha e shtatzanisë.....	58
Konsultimi.....	58
Pajisjet mbrojtëse personale	58
Shenjat dhe sinjalet në praktikën stomatologjike	58
TABELA: SISTEMI I VLERËSIMIT TË STANDARDEVE NË SHËRBIMET STOMATOLOGJIKE	59

PARATHËNIE

Standardet e propozuara në këtë dokument për akreditimin e shërbimit stomatologjik, bazohen në përvojën ndërkombetare e kryesisht atë britanike.

Ky dokument, është i dobishëm për të ndihmuar shërbimin stomatologjik publik dhe privat për të krahasuar nivelin e performancës së tyre bazuar në standarde ndërkombëtare.

Grupi i punës është përpjekur të bëjë më të mirën nëpërmjet rishikimit të përvojave ndërkombëtare dhe zhvillimit të standardeve në përputhje me Shërbimin Stomatologjik Shqiptar.

Kjo do të nxisë ndryshime pozitive në shërbimin stomatologjik duke ofruar perspektivën e krahasimit me shërbimet më të mira botërore.

Anëtarët e grupit të punës inkurajojnë të gjithë kolegët të fillojnë vetë-vlerësimin e situatës së shërbimit ku ata punojnë dhe të ndihmojnë kolegët e tjerë në këtë vetë-vlerësim. Në të ardhmen, metodologjia e vlerësimit, procesi i vendim-marrjes dhe trajnimi i mbikëqyrësve do të jenë një proces që do të paraprijë programin e plotë të akreditimit.

Standardet që përshkruhen në këtë dokument, paraqesin variantin përfundimtar të arritur pas diskutimeve të gjera me grupin e profesionistëve të sipër-përmendur. Ky dokument do të jetë në rishikim dhe përmirësim të vazhdueshëm duke ju përshtatur problematikës dhe kërkesave të kohës.

Grupi i punës është i ndërgjegjshëm që niveli i standardeve të propozuara është i lartë dhe si fillim këto standarde do vlejnjë për vetë-vlerësim të performacës. Pas miratimit në Parlament të Ligjit për Akreditimin e Institucioneve Shëndetësore, do kalohet në vlerësimin e jashtëm apo akreditimin.

Sugjerohet që të ketë standarde minimale, standarde optimale dhe standarde të së ardhmes.

Standardet e propozuara për shërbimin stomatologjik janë ndarë në tre kategori:

- 1) Standardet minimale (***në shkronja italiqe të theksuara***), [***me ngjyrë të kuqe***]. ***Jane 58 standarde minimiale.***
- 2) Standardet optimale (***të printuara në shkronja të zakonshme por të theksuara***) (***nga anglishtja-bold***), [***me ngjyrë blu***]. ***Jane 47 standarde optimale.***
- 3) Standardet e të ardhmes (***të shtypura në shkronja të thjeshta***) [***me ngjyrë jeshile***]. ***Jane 34 standarde te se ardhmes.***

Ne total , jane 139 standarde

Për tu akredituar, praktika dentare apo stomatologjike duhet të plotësojë të gjitha standardet minimale dhe të arrijë rezultatin e përgjithshëm prej 80 përqind të standardeve optimale. Standardet e së ardhmes paraqesin një kufi madje edhe më të lartë. Për tu akredituar, praktika stomatologjike duhet të arrijë së paku rezultatin prej 60 përqind të standardeve të së ardhmes.

DREJTORI i QK-CSA
Prof. Dr Isuf KALO

HYRJE

Këto standarde bazohen në kornizën e standardeve britanike të përshkruara hollësisht në standardet për një shëndet më të mirë [nga anglishtja “Standards for Better Health”], të cilat janë publikuar nga departamenti i shëndetit (the Department Health (DH) in 2004).

(i disponueshëm në: <http://www.dh.gov.uk/assetRoot/04/08/66/66/04086666.pdf>).

Ndërkaq të gjitha referencat e nevojshme për tu thelluar në çdo kapitull/fushë standardesh dhe nën-standardesh, paraqiten në kapitullin e bibliografisë në fund të këtij dokumenti.

Standardet vendosin një nivel cilësie në shërbimin stomatologjik, për të cilën shërbimet publike dhe private duhet të aspirojnë për ti plotësuar.

Standardet janë përshkruar për të mbuluar të gjitha shërbimet pavarësisht se ku ato ndodhen, përfshirë edhe shërbimin stomatologjik në kujdesin shëndetësor parësor publik.

Këto standarde të propozuara për Strukturën e Shërbimit Stomatologjik shoqërohen me Standardet Për Profesionistët Stomatologë dhe së bashku plotësojnë njëri-tjetrin.

Vizioni dhe qëllimi i standardeve

Ky dokument specifikon kërkesat për mbarëvajtjen e shërbimit stomatologjik. Ai mbulon organizmin, menaxhimin, burimet njerëzore dhe financiare si dhe vlerësimin e veprimtarisë në drejtim të përmirësimit të cilësisë. Qëllimi i përpilimit të këtyre standardeve është rritja e cilësisë në Shërbimin Shëndetësor Stomatologjik Shqiptar dhe përcaktimi i normave për akreditimin e praktikës stomatologjike, mbështetur në standardet e nivelit ndërkombëtar.

Struktura e standardeve

Janë gjithsej 16 kapituj apo fusha standardesh. Secila fushë ka të përshkruar përmbajtjen në formë të shkurtuar. Fushat zbërthehen në disa nën-standarde që shënohen me numra rendor, si për shembull: 1.1., 1.2., etj. Në fund të secilit standard kryesor jepen edhe referencat, ku secili mjek stomatolog mund të konsultohet për një informacion më të detajuar.

Standardet për praktikën stomatologjike

Metodologjia e punës u bazua në konsultimin e përvojave ndërkombëtare, diskutimeve të gjera, debate si dhe pjesëmarrje aktive e të gjithë anëtarëve të grupit.

Çdo standard paraqitet me këtë strukturë:

Përmbajtja

Nën-standardet me ndarje, si për shembull: 1.1, 1.2, etj..

Elementët matës

Pikëzimi apo vlerësimi me pikë

Standardet përshkruhen në 16 kapituj apo fusha si mëposhtë:

Mjedisi, pajisjet dhe aparaturat

Mbrojtja nga rreziqet në praktikën (dentare) stomatologjike

Kontrolli i Infeksionit

Shëndeti dhe siguria
Ekzaminimi radiologjik dentar
Laboratori dentar
Kartela e pacientit
Stafi dhe trajnimi i tij
Emergjencat (urgjencat) Mjekësore
Informacioni për Pacientin
Komunikimi dhe regjistrimi i të dhënave
Kërkesat mediko-legale
Menaxhimi i praktikës dentare
Informatizimi i të dhënave
Parandalimi
Anestezia e përgjithshme dhe sedacioni me ruajtje të ndërgjegjes

Materiali ka edhe dy anekse të hollësishme:
ANNEX I: Pajisjet dhe instrumentet

ANNEX II: Shëndeti dhe Siguria në punë

TERMINOLOGJIA

Cilësia përkufizohet si më e mira e mundshme apo si niveli i përmbushjes së objektivave në përputhje me atë çfarë pret profesionisti, popullata apo pacientët.

Përbërësit e cilësisë janë:

Struktura – infrastruktura, objekti/godina, pajisjet, organizimi, burimet njerëzore, financiare dhe teknike në dispozicion

Procesi - si përdoren burimet e mësipërme për të arritur rezultatet

Rezultatet- çfarë rezultatesh arrihen (niveli i performancës).

Vlerësimi i **Performancës** është një proces i vazhdueshëm, nëpërmjet të cilit dentisti apo stomatologu dhe çdo anëtar stafi vlerëson performancën e shërbimit stomatologjik, vendos objektivat dhe vlerëson progresin në drejtim të arritjes së këtyre objektivave.

Akreditimi është një procedurë sipas së cilës një autoritet zyrtar jep njohje formale të aftësisë së një institucioni (praktike dentare), i cili konfirmohet si kompetent për të kryer detyra të caktuara.

Standardi është niveli i dëshëruar dhe i arritshëm i performancës, kundrejt të cilit matet performanca aktuale.

Mbikëqyrja është një vlerësim i jashtëm dhe i barabartë, i cili mat performancën e shërbimit stomatologjik përkundrejt një grupi të pranuar standardesh.

Mbikëqyrësi është një vlerësues/rishikues i jashtëm i performancës së shërbimit stomatologjik, përkundrejt një grupi të publikuar dhe pranuar standardesh.

Vlerësimi nga kolegë (peer assessment) është procesi gjatë të cilit performanca e një institucioni, praktikë e individëve ose grupeve të individëve, vlerësohet nga anëtarët apo kolegët e institucioneve të ngjashme ose të të njëjtit profesion ose disiplinë.

Bordi i Akreditimit është organi përgjegjës për Programin e Akreditimit dhe dhënien e statusit të akreditimit.

Shërbim Stomatologjik – termi, “shërbim stomatologjik”, “shërbim dentar”, “praktikë dentare”, nënkuptojnë të njëjtin koncept dhe përdoren me të njëjtin qëllim.

LISTA E STANDARDEVE TË PRAKTIKAVE APO SHËRBIMEVE STOMATOLOGJIKE

1. Mjedisi, Pajisjet dhe Aparaturat

Përmbajtja: Për të ofruar një shërbim dentar (stomatologjik) cilësor kërkohet përmbushja e disa standardeve bazë për pajisjet dhe aparaturat:

Shënim: Një listë e pajisjeve dhe aparaturave të duhura për një praktikë dentare gjendet në Aneksin I, në fund të këtij dokumenti.

1.1 Praktika dentare (kabineti dentar apo klinika dentare) është komode dhe e mirë organizuar.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikës.

Pikëzimi

5p- Praktika është e mirë organizuar.

3p- Praktika është e mirë e organizuar sipas shërbimeve

1p- Praktika nuk duket e mirë-organizuar

1.2. Praktika ka pastërti (të shkallës së lartë) në të gjithë hapësirat e saj, veçanërisht në mjedisin/ambientin ku kryhen trajtimet klinike dhe në bllokun e sterilizimit.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikës.

Pikëzimi

5p- Praktika ka paraqitje të pastër.

3p- Praktika ka paraqitje mesatarisht të pastër

1p- Praktika nuk duket e pastër sidomos në bllokun e sterilizimit

1.3. Kabinetet dentare që ofrojnë shërbime kirurgjikale kanë hapsira të mëdha për të lejuar si mjekun ashtu edhe ekipin e tij të punojnë ulur në ndenjëse të veçanta. Kabineti ka një hyrje/akses të gjerë e të lehtë për hyrjen e pacientit në rast emergjence.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikës.

Pikëzimi

5p- Praktika ka hapsira të mëdha me ndenjëse të veçanta për secilin profesionist.

3p- Praktika ka hapsira të pranueshme

1p- Praktika nuk ka ndenjëse për secilin profesionist dhe nuk lejon akses të mirë në rast emergjence

1.4. Instrumentet dhe materialet vendosen në vende të veçanta, larg pacientëve dhe në kontientierë/kosha, që nuk mbajnë pluhur. (shiko kapitullin e kontrollit të infeksionit).

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikës.

Pikëzimi

5p- Praktika ka instrumentet dhe materialet në vende të posaçme krejt të pastra.

3p- Praktika ka vend për përmirësim në vendosjen e instrumenteve dhe materialeve

1p- Praktika nuk plotëson kriteret e vendosjes së instrumenteve dhe materialeve në vende të posaçme dhe shihet pluhur në to.

1.5. Dhoma, korridori ose vendi i pritjes së praktikës dentare ka një hapësirë relaksi dhe komforti me ndenjësë (karrige, kolltukë) të veçantë për pacientët (adutë e fëmijë).

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikës.

Pikëzimi

5p- Praktika ka korridor të pastër, me ndenjësë të mira për adultët dhe fëmijët

3p- Praktika ka vend për përmirësim në rregullimin komfortabël të pacientëve

1p- Praktika nuk ka komoditet dhe pacientët presin në këmbë

1.6. Dhoma ose korridori i pritjes së praktikës dentare ka materiale ilustrative dhe informative për edukimin e pacientit.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikës.

Pikëzimi

5p- Praktika ka komodina me materiale të plota informative për pacientin, për gjithçka që realizohet në klinikë

3p- Praktika ka vetem disa materiale

1p- Praktika nuk ka materiale informative

1.7. Për pacientët me aftësi të kufizuara fizike në praktikën dentare, vihen në dispozicion ndenjësë apo karroca adekuate. Nëse praktika dentare nuk është në gjendje që tu ofrojë akses të përshtatshëm pacientëve me aftësi të kufizuara, ekziston informacion i posaçëm në dispozicion për ta (përmes broshurave informative që mund të jenë të disponueshme në klinikë, website, etj.), e cila ofron apo rekomandon praktikat alternative ku mund të realizohet ky shërbim specifik.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikës.

Pikëzimi

5p- Praktika ofron mundësi për akomodim të personave handikapatë dhe ka informacion për këtë aspekt në web faqen e saj

3p- Praktika ofron mundësi të kufizuara për akomodim por nuk ka informacion në web faqen e saj

1p- Praktika nuk ofron mundësi akomodimi për persona handikapatë

1.8. Praktika ka tualete të veçantë për pacientët.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikës.

Pikëzimi

5p- Praktika ka tualet për pacientët
1p- Praktika nuk ka tualet për pacientët

1.9. Praktikantët dentare që ndodhen mbi katin përdhe janë të pajisura me ashensorë.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikës.

Pikëzimi

5p- Praktika ka ashensor
1p- Praktika nuk ka ashensor

1.10. Kartelat e pacientëve ose të dhënat kompjuterike mbrohen në përputhje me legjislacionin. (shiko kapitujt e tjerë)

Vlerësimi

Vëzhgimi i dokumentacionit

Pikëzimi

5p- Praktika ka të mbrojtur dokumentacionin si në kartela, ashtu edhe në kompjuter
1p- Praktika nuk ka mbrojtje të dokumentacionit

Një listë e pajisjeve dhe aparaturave të duhura për një praktikë stomatologjike gjendet në Aneksin I. në fund të këtij dokumenti.

Referencat:

Seksioni 1 (Hapsira dhe objektet në të) dhe 2 (Dhoma e trajtimit) sipas FFGDP(UK) Practice Questionnaire- Pyetësi i Praktikës
Aftësitë kryesore-Key Skill: KS 5.1

Lexime të mëtejshme:

Meehan J. How to avoid local anaesthetic toxicity. Br Dent J 1998;184:334-5.
Health and Safety at Work etc. Act 1974. London: Stationery Office, 1974.
Control of Substances Hazardous to Health Regulations 2002. London: Stationery Office, 2002.
Management of Health and Safety at Work Regulations 1999. London: Stationery Office, 1999.

2. Mbrojtja nga rreziqet në praktikën dentare

Përmbajtja: Mbrojtja nga rreziqet në praktikën dentare për pacientët, personelin dhe komunitetin është prioritet, detyrë profesionale dhe ligjore. Me qëllim shmangien dhe mbrojtjen nga rreziqet kërkohet përmbushja e disa standardeve bazë, të cilat janë:

2.1. Personeli që kujdeset për pacientët është i imunizuar ndaj hepatitit B. Gjendja imunitare regjistrohet. Personeli imunizohet ndaj difterisë, poliomielitit, rubeolës, tuberkulozit, tetanosit dhe varicelës.

Vlerësimi

Vëzhgimi i dokumentacionit të gjendjes imunitare dhe vaksinore të profesionistëve dentar
Intervistë me profesionistët dentar

Pikëzimi

5p-Praktika disponon dokumentacionin e plotë mbi gjendjen imunitare të punonjësve
3p- Praktika ka dokumentacion të pjesshëm dhe të pa sistemuar mirë
1p- Praktika nuk ka asnjë dokumentacion.

2.2 Ka një sistem për të eliminuar mbetjet e amalgamit dhe një komplet për ruajtjen dhe mos derdhjen e zhivës. (PS: Kjo kërkohet edhe nëse përdoret amalgam i kapsuluar). Standardi më i mirë është prania e një sistemi eliminimi të amalgamit.

Vlerësimi

Vëzhgimi i sistemit të menaxhimit të amalgamit
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p-Praktika disponon sistemin e plotë të menaxhimit të amalgamit
3p- Praktika disponon vetëm një pjesë të sistemit të menaxhimit të amalgamit
1p- Praktika nuk ka sistem për eliminimin e amalgamit.

2.3 Personeli mban syze mbrojtëse kur përdoren materiale të mprehta si dhe gjatë punës në pacientë. Syze mbrojtëse të ketë edhe personeli ndihmës, i cili asiston mjekun si dhe pacienti.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikës dhe pranisë së syzeve të mjaftueshme
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p-Praktika disponon syze për të gjithë personelin
3p- Praktika disponon vetëm një pjesë syze mbrojtëse
1p- Praktika nuk ka dhe nuk përdor syze mbrojtëse.

2.4. Maska dhe doreza mbahen nga i gjithë personeli që shërben pranë karriges së mjekut dhe pacientit.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikës dhe pranisë së maskave dhe dorezave të mjaftueshme
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p-Praktika disponon dhe përdor maska dhe doreza për të gjithë personelin
1p- Praktika nuk përdor maska dhe doreza.

2.5. Dorezat nuk kanë pudrosje, që të mos provokojnë alergji (hypo-allergenic). I gjithë personeli duhet të jetë në dijeni të rrezikut nga alergjia prej latex-it dhe të këshillohet të përdorë substanca zbutëse/larëse të duarve (pa bazë naftë) në fillim dhe në fund të ditës së punës për të reduktuar rrezikun nga alergjia prej latex-it.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikës dhe pranisë së maskave dhe dorezave të mjaftueshme
Intervistë me dentistët

Pikëzimi

5p- Praktika disponon dhe përdor doreza të pa pudrosura

1p- Praktika përdor doreza të zakonshme

2.6. Praktika ka enë ose kuti të mbyllura për ruajtjen e instrumenteve të mprehta, të cilat do të sterilizohen.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikës dhe kutive të instrumenteve
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Praktika ka bokse ose cistina të mbyllura për instrumentet e mprehtë
1p- Praktika nuk ka kuti të mbyllura për instrumentet e mprehtë

2.7. Praktika ka në dispozicion konteniere/kosha të përshtatshëm për eliminimin e materialeve të mprehta shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikës dhe kutive të instrumenteve
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Praktika ka kosha të mbyllur për instrumentet e mprehtë së bashku me dokumentet shoqëruese
1p- Praktika nuk ka kuti të mbyllura për instrumentet e mprehtë

2.8. Praktika ka konteniere, kuti të veçanta për depozitimin dhe regjistrimin e të gjitha mbetjeve klinike (me kontratë të veçantë me kompanitë përkatëse) (shiko seksionin për kontrollin e infeksionit). Të gjitha substancat e rrezikshme apo të infektuara në konteniere të posaçëm nuk duhet të preken me përjashtim të personelit të praktikës dentare.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikës dhe kutive të mbetjeve klinike
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Praktika ka kosha të veçantë për mbeturinat klinike me kontratë me kompanitë e hedhurinave
1p- Praktika nuk ka kosha të veçantë për mbeturinat klinike

2.9. Në praktikë përdoren doreza të veçanta të forta për pastrimin e instrumenteve.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikës dhe dorezave të pastrimit
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Praktika ka doreza të veçanta për pastrim të instrumenteve
1p- Praktika nuk ka doreza të veçanta për pastrim të instrumenteve

2.10. Praktika ka në dispozicion një çertifikatë të vlefshme inspektimi higjieno-sanitare.

Vlerësimi

Vëzhgimi i çertifikatës
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Praktika ka çertifikatë
1p- Praktika nuk ka çertifikatë

2.11. Në praktikë autoklavi ka dokumentacionin e funksionimit normal (testet e vlerësimit të funksionit shoqëruar me datën përkatëse).

Vlerësimi

Vëzhgimi i testeve
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Praktika ka dokumentacion për testet e autoklavit
1p- Praktika nuk ka dokumentacion për testet e autoklavit

2.12. Praktika ka një regjistër dhe dokumentacion për të gjitha pajisjet elektrike dhe për inspektimin ose shërbimin e tyre periodik.

Vlerësimi

Vëzhgimi i regjistrit
Intervistë me dentistët

Pikëzimi

5p- Praktika ka dokumentacion për inspektimin
1p- Praktika nuk ka dokumentacion

2.13. Praktika ka një sistem për shuarjen e zjarrit.

Vlerësimi

Vëzhgimi i sistemit të mbrojtjes kundra zjarrit
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Praktika ka sistem për mbrojtjen kundra zjarrit
1p- Praktika nuk ka sistem mbrojtje

2.14. Në praktikë ka thasë plastik një përdorimsh (të vulosur) që përdoren për të gjitha materialet që hidhen.

Vlerësimi

Vëzhgimi i sistemit të hedhurinave
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Praktika ka qese plastike të vulosura për hedhurinat
1p- Praktika nuk ka qese të vulosura

2.15. Praktika ka komplet të ndihmës së shpejtë dhe një anëtar i personelit është i trajnuar për të dhënë ndihmën e parë.

Vlerësimi

Vëzhgimi i i kompletit të ndihmës së shpejtë dhe dokumentacionit të trajtimit
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Praktika ka kuti të ndihmës së shpejtë dhe një person është trajnuar për këtë qëllim

3p- Praktika ploteson pjesërisht keto kushte

1p- Praktika nuk ka kuti të ndihmës së shpejtë

Referencat:

Seksionet 1 (Mjedisi dhe paisjet e kabinetit) dhe 2 (dhoma e trajtimit) sipas FFGDP(UK) – Pyetsori i praktikës-Practice Questionnaire

Mjeshtëritë kryesore-Key Skills: KS 2.1, KS 2.3, KS 5.1, KS 5.2, KS 7.2

Lexime të mëtejshme:

British Dental Association. Advice sheet A3: Health and Safety Law for Dental Practice. London: BDA, 1999.

Department of Health Advisory Group on Hepatitis. Protecting Health Care Workers and Patients from Hepatitis B. London: Department of Health, 1993.

Hazardous Waste (England and Wales) Regulations 2005. London: Stationery Office, 2005.

Pressure Systems Safety Regulations 2000. London: Stationery Office, 2000.

Electricity at Work Regulations 1989. London: Stationery Office, 1989.

Medicines and Healthcare Products regulatory Agency. Guidance for the Safe Use of Lasers in Medical and Dental Practice. London: The Medical Devices Agency, 1995.

Healthcare Commission website (for laser registration) at www.healthcarecommission.org.uk as of September 2006.

Department of Health. Guidance for Clinical Health Care Workers – Protection against infection with blood-borne viruses. London: Stationery Office, 1988.

Faculty of General Dental Practice (UK). Guidance for the Management of Natural Rubber Latex Allergy in Dental Patients and Dental Healthcare Workers. London: Faculty of General Dental Practitioners (UK), 2004.

Dental Protection Ltd. Risk management module 33: Accidental injury. London: DPL Publications, 2006. Available at www.dentalprotection.org as of January 2007.

3. Kontrolli i Infeksionit

Përmbajtja: Çdo praktikë dentare ka dhe ruan standardet e pastërtisë si dhe ndjek procedura korrekte për sigurinë e pacientëve. Të gjithë pacientët konsiderohen si potencial infeksioni sepse secili prej tyre mund të jetë mbartës. Profesionistët dentarë nuk duhet të diskriminojnë pacientët bazuar në gjendjen e tyre shëndetësore. (Kodi i Etikës dhe Deontologjisë). Për këtë qëllim kërkohet përmbushja e disa standardeve bazë të cilat janë:

3.1. Sipërfaqet e kontaktit në praktikë lahen mirë dhe pastaj dezinfektohen.

Vlerësimi

Vëzhgimi i të gjitha sipërfaqeve të kontaktit në praktikë
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Praktika i ka të pa dëmtuara dhe shumë të pastra të gjitha sipërfaqet ku vendosen materialet

1p- Praktika lë për të dëshiruar për pastërtinë e sipërfaqeve të kontaktit, të cilat nuk janë intakte.

3.2. Në praktikë larja para sterilizimit bëhet me Banja Ultrasonike ose dezinfektantë larës.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikave të larjes para sterilizimit

Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Praktika i lan instrumentet me banja ultrasonike para sterilizimit

1p- Praktika lë për të dëshiruar për mënyrën e larjes së instrumenteve.

3.3. Nëse nevojitet pastrimi praparak i instrumenteve me duar, atëherë përdoren doreza të forta.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikave të larjes para sterilizimit

Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Praktika i lan paraprakisht instrumentet me doreza të forta

1p- Praktika nuk ka doreza të forta për larjen e instrumenteve dhe ato lahen pakujdesisht.

3.4. Instrumentet e përdorura hidhen (flaken) ose sterilizohen pas çdo përdorimi.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikave të larjes dhe ruajtjes/përdorimit të mëtejshëm të instrumenteve

Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Praktika ose i sterilizon ose i hedh instrumentet

1p- Praktika nuk i hedh dhe nuk i sterilizon përshtatshëm sipas procedurave.

3.5. Sterilizimi bëhet me autoklav. Në çdo autoklav vendosen strisho kontrolli, verifikimi për secilin cikël autoklavimi për të parë nëse temperatura e sterilizimit është arritur. Koha e sterilizimit dhe temperatura regjistrohen. (Një mënyrë verifikimi është edhe ndryshimi i ngjyrës së lakmuesit në letrat e plastifikimit sipas instruksionit përkatës).

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikave të sterilizimit

Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Praktika ose i sterilizon me autoklav ose i hedh instrumentet

1p- Praktika nuk i hedh dhe nuk i sterilizon përshtatshëm sipas procedurave.

3.6. Instrumentet e sterilizuara mbahen dhe ruhen të mbyllura (në kuti të posaçme me kapak) ose qese plastike të sigurta pa ajërosje.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikave të ruajtjes së instrumenteve të sterilizuara
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Praktika i ruan instrumentet e sterilizuara në kuti të mbyllura ose qese plastike pa ajër
1p- Praktika nuk i ruan instrumentet në mënyrën e përshtatshme.

3.7. Frezat pastrohen dhe sterilizohet pas çdo përdorimi.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikave të sterilizimit të frezave
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Praktika i sterilizon frezat me autoklav pas çdo përdorimi
1p- Praktika nuk i sterilizon përshtatshëm frezat sipas procedurave.

3.8. Tubat e ujit të anglave pastrohen me dezinfektant spray pas çdo pacienti.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikave të sterilizimit
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Praktika dentare i pastron anglat me dezinfektant pas çdo pacienti
1p- Praktika dentare nuk i pastron anglat sipas procedurave.

3.9. Anglat (Frezëmbajtësi, handpieces) dezinfektohen ose autoklavohen pas çdo pacienti.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikave të sterilizimit të anglave
Intervistë me dentistët

Pikëzimi

5p- Praktika dezinfekton dhe sterilizon me autoklav frezë-mbajtëset pas çdo pacienti
1p- Praktika nuk i dizinfekton anglat pas çdo pacienti.

3.10 Shiringa ajër-ujë mbahet e shtypur për 30 sekonda në pështymore në fillim të ditës së punës si dhe pas çdo pacienti.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikave të përdorimit të shiringës ajër-ujë
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Profesionistët dentar i përdorin përshtatshëm shiringat ajër-ujë në pështymore pas secilit pacient dhe në fillim të punës

1p- Praktika nuk i përdor përshtatshëm sipas procedurave.

3.11. Gjilpërat dhe instrumentet e mprehta vendosen në kontenierë specialë.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikave të manipulimit të instrumenteve
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Dentisti i vendos të gjitha gjilpërat dhe instrumentet e mprehta në kontenier të veçantë

1p- Dentisti nuk i vendos të gjitha gjilpërat dhe instrumentet e mprehta në kontenier të veçantë

3.12. Ka protokolle që ndiqen në rast dëmtimi me instrumente prerëse.

Vlerësimi

Vëzhgimi i protokolleve në rast dëmtimi
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Praktika ka protokolle që ndjek në rast dëmtimi fizik me instrumente

1p- Praktika nuk ka protokolle

3.13. Maja e shiringës ajër-ujë (tips) dezinfektohet, sterilizohet ose hidhet (maja një përdorimshe) pas çdo pacienti.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikave të manipulimit të tips-eve pas secilit pacient
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Dentisti i hedh tipset pas çdo përdorimi

1p- Dentisti nuk i hedh tipset sipas procedurave.

3.14. Masat (negativët e marrë në gojën e pacientit) desinfektohen para se të derdhen ose dërgohen në laboratorin dentar.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikave të marjes së masave
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Praktika i dezinfekton masat para se të dërgohen në laborator

1p- Praktika nuk i dezinfekton masat para se të dërgohen në laborator

3.15. Ka protokolle të shkruara për procedurat e dezinfektimit për të gjithë artikujt që dërgohen në laboratorin dentar.

Vlerësimi

Vëzhgimi i protokolleve
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Praktika vepron sipas protokolleve për procedurat e dezinfektimit për të gjithë artikujt që dërgohen në laboratorin dentar.

1p- Praktika nuk vepron sipas protokolleve për procedurat e dezinfektimit për të gjithë artikujt që dërgon në laborator dentar.

3.16. Dorezat njëpërdorimshe vishen nga i gjithë personeli i përfshirë në trajtimin e pacientëve dhe ndërrohen pas secilit pacient (shiko seksioni 2 tek “Mbrojtja nga rreziku në praktikën dentare”).

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikave të manipulimit me pacientë gjatë punës

Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Praktika përdor dorezat që vishen nga i gjithë personeli i përfshirë në trajtimin e pacientëve dhe ndërrohen pas secilit pacient

1p- Praktika nuk i përdor dorezat që vishen nga i gjithë personeli i përfshirë në trajtimin e pacientëve dhe nuk i ndërrohen pas secilit pacient

3.17. Mbeturinat klinike (përfshirë doreza të përdorura, maska, mbulesa të sipërfaqeve apo ato të pacientit) mblidhen në qese plastike dhe vendosen në vende të sigurta para se të hidhen përfundimisht në vende të përcaktuara.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikave të manipulimit të mbeturinave

Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Praktika mblodh mbeturinat klinike (përfshirë doreza të përdorura, maska, mbulesa të sipërfaqeve apo ato të pacientit) në qese plastike dhe vendosen në vende të sigurta

1p- Praktika nuk i mblodh mbeturinat klinike (përfshirë doreza të përdorura, maska, mbulesa të sipërfaqeve apo ato të pacientit) në qese plastike dhe nuk i vendos në vende të sigurta

3.18. Ka protokolle që përfshijnë marrëveshje/kontrata për hedhjen e mbeturinave klinike, gjilpërave, materiale të mprehta (shiko seksioni 2 tek “Mbrojtja nga rreziku në praktikën dentare”).

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikave të hedhurinave

Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Praktika vepron sipas protokolleve për hedhjen e mbeturinave klinike, gjilpërave, materialeve të mprehta

1p- Praktika nuk vepron sipas protokolleve për hedhjen e mbeturinave klinike, gjilpërave, materialeve të mprehta

3.19. Personeli klinik përdor veshjet e përcaktuara në ambientet klinike të praktikës dentare

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikave të veshjes së personelit
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Personeli në praktikë përdor veshje të përshtatshme
1p- Personeli në praktikë mund të shihet që përdor veshje të rrugës

3.20. Mbrojtësit e fytyrës (ose syzet) janë të disponueshëm për të gjithë stafin klinik dhe përdoren sipas nevojës.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikave të mbrojtës së fytyrës gjatë punës së personelit
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Personeli në praktikë përdor mbrojtëse të fytyrës ose syze të përshtatshme
1p- Personeli në praktikë nuk shihet që përdor mbrojtëse të fytyrës ose syze

3.21. Nëse ndonjë anëtar i personelit ka flokë të gjata, i mbledh ato në ambientet e klinikës.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikave të veshjes dhe mbedhjes së flokëve
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Personeli në praktikë që ka flokë të gjata i mbledh ato
1p- Personeli në praktikë me flokë të gjata i mban ato të lëshuara

3.22. Procedurat e sterilizimit dhe kontrollit të infeksionit janë identike për të gjithë pacientët.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikave dhe procedurave të sterilizimit
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Praktika ka dhe ndjek procedura sterilizimi dhe kontrolli të infeksionit për të gjithë pacientët
1p- Praktika nuk ka dhe nuk ndjek procedura sterilizimi dhe kontrolli infeksioni për të gjithë pacientët

3.23. Për larjen e duarve përdoren lëngje me veti baktericide.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikave të larjes së duarve
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Praktika ka dhe ndjek procedura për larjen e duarve
1p- Praktika nuk ka dhe nuk ndjek procedura për larjen e duarve dhe shihet se ndonjëhere denticiti harron të laje duart pas secilit pacient

3.24. Ka peceta një përdorimshe për fshirjen e duarve.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikave të fshirjes së duarve
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Praktika ka peceta një përdorimshe për fshirjen e duarve
1p- Praktika nuk ka peceta një përdorimshe për fshirjen e duarve pas secilit pacient

3.25. Rubinetat e ujit janë me pedale ose janë automatike.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikave të manipulimit të rubinetave të ujit
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Praktika ka rubineta uji me pedale ose automatike
1p- Praktika nuk ka rubineta uji automatike

3.26. Mbahen Syzet mbrojtëse nga pacientët dhe stafi klinik gjatë procedurave klinike.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikave të mbajtjes së syzeve
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p- Praktika ka dhe mban syze mbrojtëse si për personelin ashtu edhe për pacientët
1p- Praktika nuk mban syze mbrojtëse si për personelin ashtu edhe për pacientët

3.27. Stafi klinik ushtron kujdes për të shmangur kontaminimin e zonave ku nuk punohet. Zonat e kontaminuara dezinfektohen ose kanë mbulesa (plastike) që ndërrohen pas çdo pacienti. Këto zona përfshijnë:

3.27.1 Panelet e komandimit të poltronit.

3.27.2 Dorezat e reflektorit të ndricimit.

3.27.3 Të gjithë butonat e kontrollit të unitit dentar.

3.27.4 Sirtare dhe mbajtëse e tabakave të autoklavit.

3.27.5 Dorezat e tabakave.

3.27.6 Majat e llampës së polimerizimit.

3.27.8 Tubat lidhës të Anglave, kamerës intraorale, kavitrone, etj.

Vlerësimi

Vëzhgimi i zonave të kontaminuara nëse kanë mbulesa
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

- 5p- Praktika ka dhe mbulon me mbulesa 3.27.1. deri 3.27.8
- 3p- Praktika mbulon pjesët kryesore me mbulesa 3.27.1. deri 3.27.8
- 1p- Praktika nuk mbulon fare 3.27.1. deri 3.27.8

3.28. Përdoren përparëse njëpërdorimshe (kur është e nevojshme së bashku me qese plastike) për të mbrojtur veshjen e pacientit.

Vlerësimi

Vëzhgimi i veshjes së pacientëve me mbulesa
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

- 5p- Praktika ka dhe mbulon me përparëse pacientin
- 3p- Praktika mbulon pjesërisht me mbulesa pacientin
- 1p- Praktika nuk mbulon fare pacientin

3.29. Instrumentet e kontaminuara sterilizohen përpara se të ri-përdoren ose riparohen.

Vlerësimi

Vëzhgimi i sterilizimit të instrumenteve të kontaminuara
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

- 5p- Praktika i sterilizon instrumentet e kontaminuara
- 1p- Praktika nuk i sterilizon instrumentet e kontaminuara

3.30. Në praktikë nuk konsumohet ushqim ose pije në ambientet e punës.

Vlerësimi

Vëzhgimi i mjedisit në praktikë
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

- 5p- Në praktikë nuk përdoret ushqimi në ambiente klinike
- 1p- Në praktikë shihet që konsumohet ushqim në ambiente klinike

3.31. Të gjithë artikujt e marrë nga laboratorit dentar dezinfektohen.

Vlerësimi

Vëzhgimi i mjedisit në praktikë
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

- 5p- Në praktikë materialet e marra nga laboratorit dezinfektohen
- 1p- Në praktikë nuk dezinfektohen materialet e marra nga laboratorit

3.32. Përdoret konferdami (diga e gomës, ruber dam) për të minimizuar kontaminimin dhe infeksionet e kryqëzuara si dhe për reduktimin e aerosoleve gjat procedurave restorative dhe endodontike.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikave të punës

Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

- 5p- Praktika ka dhe përdor konferdam
- 3p- Praktika përdor pjesërisht konferdam
- 1p- Praktika nuk përdor fare konferdam

Referencat:

Section 7 (Infection control) of the FFGDP(UK) Practice Questionnaire
Key Skills: KS 2.1, KS 2.2, KS 2.3, KS 5.1, KS 5.2

Lexime të mëtejshme:

General Dental Council. Standards for Dental Professionals. London: GDC, 2005.
Available via www.gdc-uk.org/News+publications+and+events/Publications as of September 2006.

British Dental Association. Advice sheet A12: Infection Control in Dentistry. London: BDA, 2003. (Currently under review. New version expected Autumn 2006).

Marshall K. The role of rubber dam in infection control. *Indep Dent* 1998;32-35.

UN Recommendations on the Transport of Dangerous Goods, Model Regulations, 13th revised edition, Packing Instruction 602. As used in the International Air Transport Association Dangerous Goods Regulations.

Dental Protection Ltd. Risk management module 22: Cross-infection control. London: DPL Publications, 2006. Available at www.dentalprotection.org as of January 2007.

4. Shëndeti dhe siguria

Përmbajtja: Praktikantët dentarë punojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Me qëllim përmirësimit të shëndetit dhe sigurisë kërkohet përmbushja e disa standardeve:

4.1. Praktika disponon materiale informative mbi shëndetin dhe sigurinë.

Vlerësimi

Observim i gjendjes në praktikë për sa më sipër
Observim i dokumentacionit
Intervistë me drejtuesit e praktikës.

Pikëzimi

- 5p– Praktika ka materiale informative mbi shëndetin dhe sigurinë
- 3p– Gjenden vetëm një pjesë e materialeve informative mbi shëndetin dhe sigurinë
- 1p– Në praktikë nuk ka materiale informative

4.2. Praktika ka dokument për sigurinë, të shkruar dhe të ekspozuar.

Vlerësimi

Vëzhgimi i dokumenteve
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

- 5p– Gjendet dokumentacion i plotë mbi shëndetin dhe sigurinë
- 3p– Gjenden vetëm disa dokumente
- 1p– Nuk ka asnjë dokument

4.3. Praktika ka një protokoll të shkruar për përdorimin e pajisjeve kundra-zjarrit. Praktika ka pajisje kundra zjarrit që inspektohen vazhdimisht (sidomos në katet e sipërme). Afishohen procedurat për të përballuar rastet kur ka zjarr.

Vlerësimi

Vëzhgimi i protokolleve kundra zjarrit
Intervistë me profesionistin dentar

Pikëzimi

5p– Gjenden dokumentacione protokoll të shkruar për përdorimin e pajisjeve kundra-zjarrit.

1p- Nuk ka asnjë dokument mbi mbrojtjen kundra zjarrit

4.4. Praktika ka kompletin e pajisjeve të ndihmës së shpejtë. Në praktikat me mbi 25 punonjës duhet të ketë një person të kualifikuar për ndihmën e parë, çertifikata e trajnimit të tij duhet të rifreskohet. Në praktika me më pak se 25 punonjës mund të caktohet një njeri tjetër, që edhe mund të mos disponojë çertifikatë por që është trajnuar për të ndihmuar në raste aksidentesh.

Vlerësimi

Vëzhgimi i kompleksit të ndihmës së shpejtë dhe trajnimit
Intervistë me drejtuesit e praktikës.

Pikëzimi

5p– Konstatohet se praktika ka kompletin e pajisjeve të ndihmës së shpejtë dhe ka një person të trajnuar me çertifikatë (për praktikant mbi 25 vetë).

3p– Konstatohet se praktika ka kompletin e pajisjeve të ndihmës së shpejtë por nuk ka një person të trajnuar me çertifikatë.

1p- Konstatohet se praktika nuk ka kompletin e pajisjeve të ndihmës së shpejtë dhe nuk ka një person të trajnuar me çertifikatë.

4.5. Praktika ka një libër të regjistrimit të aksidenteve. Të dhënat e këtij dokumenti ruhen në mënyrë konfidenciale.

Vlerësimi

Vëzhgimi i dokumentacioneve
Intervista me drejtuesit e praktikës.

Pikëzimi

5p– Praktika ka një libër të regjistrimit të aksidenteve

1p- Praktika nuk ka një libër të regjistrimit të aksidenteve

4.6. Praktika i ruan barnat/medikamentet në kushte të përshtatshme dhe vende të sigurta sipas kategorisë apo klasifikimit.

Vlerësimi

Vëzhgimi i vendndodhjes dhe ruajtjes së barnave
Intervista me drejtuesit e praktikës.

Pikëzimi

5p– Praktika i ruan barnat në vende të sigurta dhe sipas klasifikimit

1p- Praktika nuk i ruan barnat në vende të sigurta dhe sipas klasifikimit

Një përmbledhje faktesh për shëndetin dhe sigurinë mund të gjendet në Annex II në fund të këtij dokumenti.

Referencat:

Section 1 (The premises) of the FFGDP(UK) Practice Questionnaire
Key Skills: KS 2.4, KS 5.1, KS 5.2, KS 7.2

Lexime të mëtejshme:

Health and Safety at Work etc. Act 1974. London: Stationery Office, 1974.
Management of Health and Safety at Work Regulations 1999. London: Stationery Office, 1999.
The Health and Safety (Consultation with Employees) Regulations 1996. London: Stationery Office, 1996.
Factories Act 1961. London: Stationery Office, 1961.
Fire Precautions Act 1971. London: Stationery Office, 1971.
Occupiers' Liability Acts 1957 & 1984. London: Stationery Office, 1957 & 1984.
Employer's Liability (Compulsory Insurance) Act 1969. London: Stationery Office, 1969.
Health and Safety (First Aid) Regulations 1981. London: Stationery Office, 1981.
Reporting of Injuries, Diseases and Dangerous Occurrences Regulations 1995. London: Stationery Office, 1995.
British Dental Association. Advice sheet A3: Health and Safety Law for Dental Practice. London: BDA, 1999.
Health & Safety (Display Screens Equipment) Regulations 1992. London: Stationery Office, 1992.

5. Ekzaminimi Radiologjik Dentar

Përmbajtja: Personeli dentar dhe komuniteti duhet të mbrohen nga efektet e rezatimit jonizues. Të gjithë profesionistët dentar zbatojnë aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi lidhur me përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve burim rrezatimi jonizues. Teknikat e përdorura për kryerjen dhe zhvillimin e radiografive sigurojnë vlera diagnostike maksimale dhe doza minimale rrezatimi. Për këtë qëllim kërkohet përmbushja e disa standardeve bazë, të cilat janë:

5.1. Ka (pajisje) radiografi intraorale pranë unitit dentar.

Vlerësimi

Vëzhgimi i praktikës

Pikëzimi

5p– Praktika ka pajisje radiografi intraorale pranë unitit dentar.
3p– Praktika ka (pajisje) radiografi intraorale diku jo shumë larg unitit dentar.
1p- Praktika nuk ka (pajisje) radiografi intraorale pranë unitit dentar.

5.2. Praktika ka protokolle që zbatohen gjatë ekzaminimit radiologjik

Vlerësimi

Vëzhgimi i protokolleve

Pikëzimi

5p– Praktika ka protokolle që zbatohen gjatë ekzaminimit radiologjik

- 3p– Praktika ka protokolle jo te plota gjatë ekzaminimit radiologjik
1p- Praktika nuk ka protokolle që zbatohen gjatë ekzaminimit radiologjik

5.3. Në praktikë pajisjet që prodhojnë rreze-X, kontrollohen dhe çertifikohen, bazuar në legjislacionin në fuqi.

Vlerësimi

Vëzhgimi i dokumentacionit

Pikëzimi

5p– Në praktikë pajisjet që prodhojnë rreze-X, kontrollohen dhe çertifikohen, bazuar në legjislacionin në fuqi.

1p- Në praktike pajisjet që prodhojne rreze-X, nuk kontrollohen dhe çertifikohen, bazuar në legjislacionin në fuqi.

5.4. Personeli përgjegjës për kryerjen e ekzaminimit radiografik trajnohet bazuar në rregulloret në fuqi dhe kursi i trajnimit dokumentohet. (Mjekët stomatologë përjashtohen sepse trajnimi është përfshirë në kurrikulën shkollore).

Vlerësimi

Vëzhgimi i dokumentacionit

Pikëzimi

5p– Praktika ka dokumentacion të personelit për trajnim radiologjik

1p- Praktika nuk ka dokumentacion të personelit për trajnim radiologjik

5.5. Praktika ka monitorues (dozimetër) të rezatimit nëse ngakesa e punës javore i tejkalon 100 filma intraoral ose 50 filma panoramic (ose një kombinim i tyre). Ekzaminimet radiologjike kryhen duke respektuar masat e mbrojtëse dhe të sigurisë.

Vlerësimi

Vëzhgimi i pranisë së dozimetrave dhe pajisjeve mbrojtëse

Pikëzimi

5p– Praktika mban dozimetër dhe pajisje mbrojtëse

1p- Praktika nuk mban dozimetër dhe pajisje mbrojtëse

5.6. Praktika ka monitor (radiografi digitale), i cili gjendet në një vend të përshtatshëm pranë mjekut ose në një distancë të afërt me të.

Vlerësimi

Vëzhgimi i pranisë së monitorëve

Pikëzimi

5p– Praktika ka monitor (radiografi digitale), i cili gjendet në një vend të përshtatshëm pranë mjekut gjatë trajtimit.

3p- Praktika ka monitor (radiografi digitale), i cili gjendet në një vend jo fort të përshtatshëm pranë mjekut gjatë trajtimit.

1p- Praktika nuk ka monitor (radiografi digitale).

5.7. Praktika ka rregullore të dokumentuar për mbrojtjen nga rezatimi përfshirë këtu edhe emrin e supervizorit si dhe një përshkrim të hapësirave të kontrolluara.

Vlerësimi:

Vëzhgimi i rregulloreve

Pikëzimi

5p– Praktika stomatologjike ka rregullore të dokumentuar për mbrojtjen nga rezatimi
1p- Praktika stomatologjike nuk ka rregullore të dokumentuar për mbrojtjen nga rezatimi

5.8. Filmat ekspozohen dhe zhvillohen duke ndjekur saktësisht teknikën e duhur. (e vlefshme për praktikat që ndjekin këtë procedurë)

Vlerësimi:

Vëzhgimi i ekspozimit dhe zhvillimit të filmave

Pikëzimi

5p– Filmat ekspozohen dhe zhvillohen duke ndjekur saktësisht teknikën e duhur.
1p- Filmat nuk ekspozohen dhe zhvillohen duke ndjekur saktësisht teknikën e duhur.

5.9. Filmat radiografik identifikohen, futen në këllëfa për ruajtje duke shënuar emrin, datëlindjen e pacientit dhe datën e ekzaminimit radiologjik. (përfshirë bëjnë ekzaminimet dixhitale ku pamja ruhet e identifikuar në kartelën elektronike të pacientit).

Vlerësimi

Vëzhgimi i filmave radiografike

Pikëzimi

5p– Filmat radiografik identifikohen, futen në këllëfa për ruajtje duke shënuar emrin, datëlindjen e pacientit dhe datën e ekzaminimit radiologjik.
3p- Përpunimi i filmave radiografik ka vend për përmirësim gjatë regjistrimit ekzaminimit radiologjik.
1p– Filmat radiografik nuk identifikohen qartë dhe nuk futen në këllëfa për ruajtje duke shënuar emrin, datëlindjen e pacientit dhe datën e ekzaminimit radiologjik.

5.10. Praktika ka një program të monitorimit të cilësisë që përfshin përshkrimin, teknikat dhe përpunimin e filmave radiografike si dhe kontrollin e cilësisë së pajisjeve.

Vlerësimi

Vëzhgimi i programeve.

Pikëzimi

5p– Praktika ka një program të monitorimit të cilësisë që përfshin përshkrimin, teknikat dhe përpunimin e filmave radiografik si dhe kontrollin e cilësisë së pajisjeve.
1p– Praktika nuk ka një program të monitorimit të cilësisë që përfshin përshkrimin, teknikat dhe përpunimin e filmave radiografik si dhe kontrollin e cilësisë së pajisjeve.

